

Altin Shumeli ka një eksperiencë pune mbi 20 vjecare për çështje të administratës publike dhe shërbimit civil. Z.Shumeli, ka mbaruar Fakultetin e Shkencave Sociale në degën Filozofi-Sociologji. Gjithashtu ka kryer studimet në Fakultetin e Drejtësisë dhe është diplomuar “Jurist”

Në vitin 2003-2004 ka kryer studimet master në Tokio, Japoni, ku ka marrë gradën Master për “Politika Publike”. Gjatë peridhës 1999-2003 ka punuar në Departamentin e Administratës Publike, më pas ka kryer funksionin e Drejtorit të Kabinetit dhe Zëdhënësit të Shtypit pranë Komisionit të Shërbimit Civil. Nga viti 2006 deri ne 2014, ka mbuluar funksione të ndryshme të Komisionit të Shërbimit Civil.

Prej viti 2015 kryen funksionin e Drejtorit të Mbikëqyrjes pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Nga viti 2018 është atashuar pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, si “*Mjeshtër Trajnimi*” duke kryer trajtime në fushën e Shërbimit Civil si dhe Administratës Publike.

Z.Shumeli ka kryer specializime dhe trajnime në fushën e të drejtës administrative, menaxhimit të burimeve njerëzore, administrimit publik dhe shërbimit civil.